

# Mbetjet e shëndetësisë shqiptare



## RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2022



QENDRESA  
QYTETARE



**NED**

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY  
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

AUTOR  
**STIVEN SHALA**

Krimi mjedisor vazhdon të mbetet një problematikë e theksuar në Shqipëri. Sipas Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021, grupi i veprave penale kundër mjedisit zë një peshë prej 1.12% përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë që për vitin 2020 është 1.19%.

Sipas këtij raporti rezulton se në vitin 2021 ka një ulje prej 5,14% të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit si dhe një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar me 8,23%, në krahasim me vitin 2020. Vepra penale më e shpeshtë në këtë grup veprash penale është "Prerja e paligjshme e pyjeve" me 47,13%, ndërsa vepra të tjera penale "të rëndësishme", sipas Prokurorisë, janë edhe "Ndotja e ajrit, e ujrave dhe e tokës" si dhe "Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore".

Ndërkohë në raport nuk jepen informacione të detajuara për menaxhimin apo transportimin e mbetjeve. Vetëm në fund të raportit, në tabelat e veçanta për secilin grup veprash penale. Në ndotjen e ajrit, të ujërave dhe tokës, përmenden dhe menaxhimi i mbetjeve me 11 proçedime të regjistruara dhe transportimi i mbetjeve me asnjë proçedim. Në menaxhimin e mbetjeve vetëm 1 proçedim është dërguar në gjykatë dhe nuk ka asnjë të pandehur të dënuar.

Edhe pse Shqipëria kohët e fundit është mësuar të dëgjojë shumë rreth mbetjeve, me skandalin e inceneratorëve, një tjetër rrezik vjen nga mbetjet e kujdesit shëndetësor.

Mbetjet e kujdesit shëndetësor përfshijnë të gjitha mbetjet e krijuara nga aktivitetet mjekësore. Ato përfshijnë aktivitetet e diagnostikimit, si dhe trajtimet parandaluese, kuruese dhe paliative në fushën e mjekësisë njerëzore dhe veterinare.

Me fjalë të tjera, konsiderohen si mbetje të kujdesit shëndetësor të gjitha mbetjet e prodhuara nga një institucion mjekësor (publik ose privat), një strukturë kërkimore mjekësore ose një laborator. Ato janë një nëngrup i mbetje të krijuara në objektet e kujdesit shëndetësor, si spitalet, zyrat e mjekëve, praktikat dentare, bankat e gjakut dhe spitalet/klinikat veterinare, si dhe objektet dhe laboratorët e kërkimit mjekësor.

Aktivitetet e kujdesit shëndetësor mund të gjenerojnë lloje të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme. Keqmenaxhimi i këtyre mbetjeve mund të rezultojë në rreziqe për mjedisin dhe shëndetin në punë.

Burimet kryesore të mbetjeve të kujdesit shëndetësor janë:

- spitale dhe objekte të tjera shëndetësore;
- laboratorët dhe qendrat kërkimore;
- qendrat e mortit dhe autopsisë;
- laboratorët e kërkimit dhe testimit të kafshëve;
- bankat e gjakut dhe shërbimet e grumbullimit;
- shtëpi pleqsh për të moshuarit;

Nga sasia e përgjithshme e mbetjeve të krijuara nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor, rreth 85% janë mbetje të përgjithshme, jo të rrezikshme.<sup>1</sup>

15% e mbetur konsiderohet si material i rrezikshëm që mund të jetë infektiv, toksik ose radioaktiv.

Më shumë se 90 përqind e mbeturinave mjekësore potencialisht infektive digjeshin para vitit 1997. Në gusht të vitit 1997, EPA<sup>2</sup> shpalli rregulloret që krijonin standarde të rrepta të emetimit për inceneratorët e mbeturinave mjekësore për shkak të shqetësimeve të rëndësishme mbi cilësinë e demshme të ajrit që ndikon në shëndetin e njeriut.

Edhe në Shqipëri sikurse të gjitha llojet e mbetjeve edhe ato spitalore shpeshherë janë problematike. Kjo sepse ato përfundojnë vend e pavend në vende publike duke qenë potencialisht vatër e përhapjes së sëmundjeve infektive.

### **Ndikimi në mjedisi i mbetjeve spitalore**

Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të kujdesit shëndetësor mund të përbëjë reziqe shëndetësore në mënyrë indirekte nëpërmjet lëshimit të patogjenëve dhe ndotësve toksikë në mjedis.

Hedhja e mbetjeve të patrajtura të kujdesit shëndetësor në depo mund të çojë në ndotjen e ujërave të pijshëm, sipërfaqësor dhe nëntokësor nëse ato depo nuk janë ndërtuar siç duhet.

Trajtimi i mbetjeve të kujdesit shëndetësor me dezinfektues kimikë mund të rezultojë në çlirimin e substancave kimike në mjedis nëse ato substanca nuk trajtohen, ruhen dhe asgjësohen në një mënyrë të shëndoshë për mjedisin.

Djegia e mbetjeve është praktikuar gjerësisht, por djegia e pamjaftueshme ose djegia e materialeve të papërshtatshme rezulton në çlirimin e ndotësve

<sup>1</sup> [https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/health-care-waste?fbclid=IwAR0zH3vBkUcQZp\\_TPey6lBXgb1aIJD2jd6GeHadilCrs6xKjHcQ9FQiOKrw](https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/health-care-waste?fbclid=IwAR0zH3vBkUcQZp_TPey6lBXgb1aIJD2jd6GeHadilCrs6xKjHcQ9FQiOKrw)

<sup>2</sup> <https://www.epa.gov/>

në ajër dhe në gjenerimin e mbetjeve të hirit. Materialet e djegura që përmbajnë ose trajtohen me klor mund të gjenerojnë dioksina dhe furane, të cilat janë kancerogjene për njerëzit dhe janë shoqëruar me një sërë efektesh negative shëndetësore. Djegia e metaleve të rënda ose materialeve me përmbajtje të lartë metali (në veçanti plumbi, zhiva dhe kadmiumi) mund të çojë në përhapjen e metaleve toksike në mjedis.

Vetëm inceneratorët modernë që funksionojnë në 850-1100 °C dhe të pajisur me pajisje speciale për pastrimin e gazit janë në gjendje të përputhen me standardet ndërkombëtare të shkarkimeve për dioksinat dhe furanet.

Alternativat e djegies si autoklavimi, mikrovalë, trajtimi me avull i integruar me përzierjen e brendshme, të cilat minimizojnë formimin dhe çlirimin e kimikateve ose emetimeve të rrezikshme duhet të merren parasysh në mjedise ku ka burime të mjaftueshme për të operuar dhe mirëmbajtur sisteme të tilla dhe asgjësimin e mbetjeve të trajtuara. .

Me propozimin e e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë vendosi në vitin 2010 miratimin e Rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore".

Kjo rregullore përcaktonte qartë procedurat, rregullat dhe standardet teknike për administrimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit.

Sipas rregullores:

- a) "Mbetje spitalore" janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku përfshihen: mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve".

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 99, në vitin 2005 miratohet katalogut shqiptar për klasifikimin e mbetjeve duke klasifikuar mbetjet e prodhuara në vend e duke I listuar sipas natyrës së tyre. Sipas katalogut mbetjet janë të ndara në mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

- b) "Prodhues i mbetjes" është personi fizik dhe juridik, i cili zotëron ose administron një institucion shëndetësor, që krijon mbetje spitalore, duke

përfshirë dhe duke mos u kufizuar vetëm në: spitale, poliklinika, qendrat shëndetësore, kabinete mjekësore, qendra mjekësore, kabinete dentare, klinika dentare, laboratorë dentarë, qendra diagnostike, depo farmaceutike, farmacitë, qendra kozmetike, qendra të tatuazhit, qendra të rehabilitimit nga droga, laboratorët e shëndetit publik, institucionet kërkimore-shkencore, banka e gjakut, morget, shërbimet funerale, klinikat veterinare, shërbimet ambulatorë të infermierisë që vizitojnë pacientë në banesa.

c) "Zotërues i mbetjeve spitalore" është personi fizik e juridik, i cili krijon mbetje spitalore, grumbullon, ruan përkohësisht, transporton dhe largon për në vendin e caktuar mbetjeve spitalore të prodhuara prej tij, si dhe i përpunon e i asgjëson ato.

Qëndresa Qytetare iu drejtua me një kërkesë për informacion Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor për menaxhimin e mbetjeve spitalore në qytetin e Shkodrës, Durrësit, Elbasanit dhe Korçës.

Në përgjigjen e kthyer, Drejtoria shprehet se menaxhimi i mbetjeve spitalore në këto qytete bëhet konform protokollit të përcaktuar në legjislacionin përkatës të asgjësimit të mbetjeve spitalore, protokoll i cili ndiqet nga firmat që fitojnë të drejtën për asgjësimin e tyre duke zbatuar VKM nr.798, datë 29.9.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore".

Drejtoria e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor na vendosi në dispozicion kontratat publike të shërbimit për qytetet Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë.

## **KORÇE**

Për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, Drejtoria e Shërbimit Spitalor të Korçës e lidh kontratën me 19.07.2021 me operatorin kontraktues MEDI-TEL shpk. Kontrata ka vlerën e kontraktuar 412 920 lekë me TVSH.

MEDI-TEL sipas OpenCorporates<sup>3</sup>, ka përfituar plot 101 kontrata publike në sektorin e shëndetësisë., me shumën totale prej 190 409 136.67, nga 26 autoritete kontraktuese.

Gjithashtu Spitali i Korçës ka kontratë me Subjektin "Rej" sh.p.k. për largimin e mbetjeve urbane, ku nuk përfshihen mbetjet spitalore të rrezikshme.

Kontrata për Spitalin e Korçës lidhet me datë 25.03.2022 mes Spitalit të përfaqësuar nga. Drejtori, z. Litian Broka, dhe Administratorit të "REJ", z. Luan Kapri.

Objekti i kësaj kontrate është "largim, përpunim i mbetjeve (urbane) dhe pastrim i territorit nga dëbora" me 311 ditë shërbimi, me vlerë 639 030 lekë me tvsh.

Krahas kësaj, institucioni disponon dhe një impiant autoklavë për përpunimin e mbetjeve të rrezikshme të kodit 18.00.01, ku përfshihen mbetjet e mprehta si agë shiringa dhe erigatere dhe bisturi. Ky autoklavë është i pajisur me leje mjedisore dhe funksionon brenda territorit të spitalit.

## SHKODER

Në përgjigje të kërkesës për informacion Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër na vendosi në dispozicion kontratën e mbetjeve të rrezikshme, kontratën e mbetjeve urbane, lejet mjedisore përkatëse dhe raportimet për vitet 2020 dhe 2021.

Kontrata me objekt "Evadim i mbetjeve të rrezikshme" lidhet në Shkodër më 17.01.2022 mes Spitalit Rajonal Shkodër të përfaqësuar nga drejtoresha, zonja Xheni Halili, dhe "V.A.L.E Recycling sh.p.k", Lezhe Fushe Kuqe Gurez.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave është 1 822 080 lekë pa tvsh, me afat ekzekutimi deri më 31.12.2022. Oferta fituese është 1 081 860 lekë pa tvsh.

<sup>3</sup> <https://opencorporates.al/sq/nipt/J71519004w>

Tre ish-in operatorët konkurues: V.A.L.E Recycling sh.p.k, MEDI-tel shpk dhe EKO RIKIKLIM, ku ky i fundit skualifikohet për shkak se ka paraqitur vetëm formular ofertë dhe asnjë dokument tjetër.

Sipas kontratës, mbetjet e rrezikshme spitalore duhet të asgjësohen në një impiant me metodën e incenerimit që është i licensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi me leje mjedisore të standartizuar. Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave të kushteve të Spitalit Rajonal Shkodër, në zbatim të kushteve të përcaktuara në kontratë.

Leja e mjedisit e tipit A, për "V.A.L.E Recycling sh.p.k", me nr. Nipt L28029301Q, me adresë Fshati Gurëz, afër ish-Kanalit të Acidit, Gurëz, Fushë Kuqë, Laç, Lezhë jepet me 26.05.2022, me titull instalimi: "incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi". Në përshkrimin e veprimtarisë thuhet "Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Sipërfaqja e objektit ku zhvillohet veprimtaria është 355.87m<sup>2</sup>. Kapaciteti i projektuar për një impiant incinerimi është 30-50 kg/cikël, ndërsa për funksionimin njëkohësisht të dy impianteve të incinerimit është 60-100 kg/cikël".

V.A.L.E Recycling sipas OpenCorporates<sup>4</sup> ka fituar plot 45 kontrata publike në sektorin e shëndetësisë me një vlerë totale prej 78 078 715 lekë.

Për largimin e mbetjeve urbane, kontrata për Spitalin Rajonal të Shkodrës lidhet me datë 18.03.2022, mes Spitalit të përfaqësuar nga drejtoresha, zonja Xheni Halili, dhe bashkimit të operatorëve, Karl Gega Konstruksion me nipt J66703076Ë dhe ALB-Konstruksion me nipt J76705049N.

Objekti i kësaj kontrate është "evadim i mbetjeve urbane", me afat 24 muaj, me vlefte totale 2 683 082 lekë me tvsh.

Në përshkrimin e shërbimeve që do ofrohen përmendet:

- Pastrim dhe evadim i mbeturinave urbane dhe transport drejt Landfillit të Bushatit
- Pastrim dhe disinfektim me klor dhe gëlqere pluhur i vendgrumbullimeve të mbeturinave
- Mirëmbajtje e kontenierëve të grumbullimit të mbeturinave urbane

<sup>4</sup> <https://opencorporates.al/sq/nipt/L28029301Q>

“Karl Gega Konstruksion” pajiset me leje mjedisi të tipit C më 12.07.2018. Titulli i instalimit përfshin “pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambulazheve/paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren. Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive.” Në përshkrimin e veprimtarisë thuhet: “grumbullim i mbetjeve jo të rrezikshme dhe transportimi i tyre në landfillin e Bushatit. Kapaciteti 8 ton ditë”.

Qëndresa Qytetare analizoi dhe raportet mbi mbetjet spitalore në Spitalin Rajonal të Shkodrës për vitet 2020 dhe 2021.

Në vitin 2020 në Spitalin Rajonal të Shkodrës, me 478 shtretër, numri i pacientëve të administruar është 9240 pacientë, me një përqindje vjetore të shfrytëzimi të shtratit prej 20.74%. Sipas formatit të raportimi, Spitali Rajonal ka prodhuar dhe trajtuar vetëm 18000 kg mbetje infektive dhe 1600 mbetje patologjike, vlera këto shumë të ulëta. Raporti thotë se Spitali i trajton mbetjet e mprehta të ngurta me hidrokлавën që disponon Spitali, ndërsa mbetjet anatomike me kontratë trajtohen me metodën e incenerimit.

Në 2020, subjekti i kontraktuar për trajtimin e mbetjeve spitalore ishte “Pura Medical”.

Në vitin 2021 pyetësi për prodhimin dhe administrimin e mbetjeve spitalore merret më seriozisht nga Spitali Rajonal Shkodër. Në vitin 2021 në Spitalin Rajonal të Shkodrës, me 478 shtretër, numri i pacientëve të administruar është 10668 pacientë, me një përqindje vjetore të shfrytëzimi të shtratit prej 23.5%.

Sipas formatit të raportimi, Spitali Rajonal ka prodhuar dhe trajtuar 154 875 kg mbetje. Sasia që është trajtuar nga vetë spitali është 136 875 kg, ndërsa me kontratë janë trajtuar 16 200kg.

V.A.L.E Recycling kontraktohet gjithashtu për asgjësim të mbetjeve farmaceutike nga Drejtoria e Spitalit Rajonal të Shkodrës, në shkellje sipas Open Procurement<sup>5</sup>. Tenderi është shënuar me flamur të kuq për shkak të “skualifikimit të gjithë operatorëve konkurrues përveç fituesit” dhe “anullimit të tenderit dy ose më shumë herë”.

<sup>5</sup> <https://openprocurement.al/sq/htender/vieë/id/19046>



## DURRËS

Kontrata për Spitalin Rajonal Durrës lidhet me datë 20.01.2022 mes Spitalit të përfaqësuar nga Zv. Drejtori i Shërbimeve Klinike, z. Genti Kavaja, dhe Administratorit të "V.A.L.E Recycling Sh.p.k", z. Elvis Miri.

Objekti i kësaj kontrate është "transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore" me afat 24 muaj, me vlerë 4 176 000 me tvsh.

Në përshkrimin e shërbimeve shprehet qartazi "transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore" duke specifikuar:

- mbetjet e mprehta dhe mbetjet me potencial infektiv të cilat do të asgjësohen me autoklavim sipas VKM 798, datë 29.09.2010, "Për administrimin e mbetjeve spitalore".
- Mbetjet anatomike, mbetjet e medikamenteve të skaduar, medikamente citostatike dhe citotoksike, materiale të ndotur me citostatike të cilat do të asgjësohen me incenerim sipas VKM 798.

## ELBASAN

Kontrata për Qendrën Spitalore të Elbasanit lidhet me datë 04.03.2021 mes Spitalit të përfaqësuar nga. Drejtori, znj. Dasantila Tahiraj, dhe Administratorit të "ECO RIKIKLIM sh.p.k", z. Ervin Mece.

Objekti i kësaj kontrate është "grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore" me afat deri në 2023, me vlerë 23 700 000 lekë me tvsh.

ECO RIKIKLIM kontraktohet për grumbullim, trajtim dhe asgjësim të mbetjeve spitalore nga Qendra Spitalore "Xhafer Kongoli" Elbasan, në shkëlqje sipas Open Procurement<sup>6</sup>. Tenderi është shënuar me flamur të kuq për shkak të "mungesës së konkurrencës".

Prokurimi zhvillohet me një konkurrent të vetëm. Ligji shqiptar i lejon këto lloj procedurash. Shpesh këto procedura me shumë se mungesë konkurrence

<sup>6</sup> <https://openprocurement.al/sq/htender/vieë/id/11612>

në treg shfaqin opsione të formulimit të kriterve dhe afateve për dorëzim dokument në favor të një kompanie të paramenduar klienteliste. Këto tendera meritojnë të konsiderohen të ekspozuara dhe me risk.

ECO RICIKLIM, sipas OpenCorporates<sup>7</sup>, ka përfituar 43 kontrata publike në sektorin e shëndetësisë. Shuma e përfituar nga 11 autoritete kontraktuese në total është 360 476 835,04. Shoqëria ka përfituar 9 kontrata me vlerë totale 179 295 733 vetëm nga Spitali Universitar i Traumës.

ECO RICIKLIM është përmendur gjithashtu dhe në rastin e kontratave sekrete gjatë pandemisë, kontrata këto të analizuar në raportet e kaluara të Qëndresës Qytetare.

Me vendimin nr.273, datë 3.4.2020, Këshilli i Ministrave miraton kontratën për lotin 2 me objekt "trajtim dhe asgjësim të mbetjeve që dalin nga shërbimet ku marrin trajtim pacientët me covid-19 për QSUT", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "ECO RICIKLIM", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me justifikimin e interesave thelbësorë të shtetit.

Katër kompanitë që kanë aktivitet në fushën e trajtimit të mbetjeve spitalore janë:

- Pura medical
- Vale Recycling
- Medi-Tel
- ECO RICIKLIM
- 

Nuk janë të pakta rastet ku mediat raportojnë për praninë e mbetje spitalore pranë lumenjve të qyteteve të ndryshme. Portali Shqiptarja.com ka raportuar raste të shumta. Rasti i parë paraqet praninë e mbetjeve spitalore në lumin Drinos në Gjirokastër ku banorët shprehen se ky është një rast i përsëritur.<sup>8</sup>

<sup>7</sup> <https://opencorporates.al/sq/nipt/l61814009b>

<sup>8</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/pushtohet-nga-mbetjet-spitalore-lumi-drinos-ne-gjirokaster-banoret-kemi-bere-kerkese-se-can-njeri-koken-po-doli-lumi-jemi-te-vdekur>

Rasti i dytë paraqet pamjet e përroit në fshatin Izvor të Memaliajt janë ku mbizotërojnë shiringa, shishe serumi, ampula, ambalazhe të mjekimeve të ndryshme fare pranë zonës së banuar.<sup>9</sup>

Tjetër rast është ai i përroit të Arbanës dhe lumit Erzen ku mbetjet spitalore përveçse përfundojnë në det, vadisin dhe tokat e fshatarëve të zonës.<sup>10</sup>

Edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka trajtuar problematikën e mbetjeve spitalore duke dalë në përfundimin se kompanitë private që ofrojnë shërbimet e trajtimit dhe asgjësimit nuk janë transparente mbi procedurat e asgjësimit të mbetjeve spitalore, as nëse i asgjësojnë realisht, ndërkohë që Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera përgjegjëse nuk bëjnë asnjë kontroll.

Në raportin e KLSH thuhet se disa kompani që kanë lidhur kontrata me spitalet për menaxhimin e mbetjeve kanë mashtruar me adresën ku kanë pretenduar se përpunojnë dhe asgjësojnë mbetjet e rrezikshme spitalore. Nga verifikimet e KLSH, ka rezultuar se në dhe pikat ku disa kompani kanë deklaruar se asgjësojnë mbetet, në realitet ka rezultuar se nuk kryhet asnjë veprimtari trajtimi/asgjësimi e mbetjeve spitalore. Ky skandal, sipas KLSH, është prodhuar nga mungesa e monitorimit.

Duke u ndaluar tek faza e monitorimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, thekson në raport se "Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave nuk disponon listën e plotë e të saktë të kompanive private të cilat trajtojnë/asgjësojnë mbetjet spitalore. ISHMPU nuk ka të dhëna se ku përfundon mbetja nga djegia ose hiri që përftohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore nëpërmjet incenerimit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka vendosur në kushtet e lejeve mjedisore domosdoshmërinë e analizimit të hirit që përftohet nga djegia e mbetjeve spitalore duke mos patur në konsideratë VKM nr.798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore".

<sup>9</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/krim-mjedisor-ne-memaliaj-mbetjet-spitalore-hidhen-ne-perrua-ne-rrezik-shendet-i-banoreve-te-izvorit>

<sup>10</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/tjeter-mine-ekologjike-shirignat-e-inerte-pushtojne-erzenin-banoret-e-ndroqit-ujitja-me-uje-te-ndotur-rrezikon-bimesine-vezhgimi-i-report-tv>

## Gjetje dhe rekomandime

- Asgjësimi i mbetjeve spitalore është kthyer në një minierë ari për individë dhe operatorë të caktuar, të cilët vetëm përfitojnë në kurriz të taksapaguesve, duke mos e ofruar shërbimin për të cilin kontraktohen dhe duke vënë në rrezik jetën e qytetarëve. Mungesa e hetimit nga ana e institucioneve të drejtësisë për këto operatorë të cilët janë gjetur në shkelje disa herë si dhe mungesa e monitorimit nga institucionet përgjegjëse për politikën mjedisore mbeten problematike.
- Mungesa e ndërgjegjësimit për rreziqet shëndetësore që lidhen me mbetjet e kujdesit shëndetësor, trajnimi joadekuat për menaxhimin e duhur të mbetjeve, mungesa e sistemeve të menaxhimit dhe depozitimit të mbetjeve, burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore dhe prioriteti i ulët që i jepet temës janë problemet më të zakonshme që lidhen me temën dhe në të njëjtën kohë edhe problemet më pak të trajtuara.
- Menaxhimi i mbetjeve të kujdesit shëndetësor kërkon vëmendje dhe zell të shtuar për të shmangur rezultatet e pafavorshme shëndetësore që lidhen me praktikën e dobët, duke përfshirë ekspozimin ndaj agjentëve infektivë dhe substancave toksike.
- Në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të kujdesit shëndetësor duhet pasur parasysh zhvillimi i strategjive dhe sistemeve së bashku me mbikëqyrjen dhe rregulloren e fortë për të përmirësuar në mënyrë graduale praktikën e ndarjes, shkatërrimit dhe asgjësimit të mbetjeve me qëllimin përfundimtar të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përkushtimi dhe mbështetja e qeverisë nevojitet për një përmirësim universal dhe afatgjatë, megjithëse mund të ndërmerren veprime të menjëhershme në nivel lokal.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NED

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)